



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:236720

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05410638

C.nr. 236/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.Sh nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, të cilin e përfaqëson Z.I avokat në Prishtinë, rruga ..., kundër të paditurës K... me seli në Prishtinë, objekt kontesti Kompensim i dëmit, jashtë seance me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr.236/2017 e datës 29.05.2017, e paditësit R.Sh nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurës K... me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen kontestimore- Kompensim i dëmit.

A r s y e t i m

Paditësi R.Sh nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, përmes të autorizuarit të tij, me datë 29.05.2017, në këtë gjykatë ka ushtruar padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës K... me seli në Prishtinë.

I autorizuari i paditësit me parashtresën e datës 04.03.2024, e ka njoftuar gjykatën se me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, andaj edhe e tërheqë padinë në këtë çështje kontestimore.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:236720
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05410638

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil
C.nr. 236/2017, me datë 05.03.2024

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.